Kronikë

Operacioni 'Revanshi' vijon/ SPAK e kërkonte, arrestohet në Shijak Astrit Avdylaj! Ndoka dhe Martinaj i kërkuan ndihmë për të vrarë Bamin

RENEA e arrestoi në vilën e rrethuar me mure të larta në Shijak. I Cilësuar si kreu i grupit të kriminal të Shijakut Avdylaj është në mes të 50 emrave që SPAK firmosi urdhërarrestë në kuadër të operacionit "Revanshi"

- Kush është Astrit Avdylaj, kreu i bandës së Shijakut! Nga vrasja në '97 tek droga, e gjithë jeta nëpër burgje
- U arrestua sot nga RENEA, si u lirua nga paraburgimi Astrit Avdylaj dhe gjyqi për 200 kg heroinë në laboratorin e Hasit
- VIDEO/RENEA mësyn vilën me mure të larta

Redaksia
29 Qershor, 13:15 | **Përditesimi: 29 Qershor, 17:48**

Share

Shijak- Pas rreth një muaji në arrati ku i shpëtoi operacionit 'Revanshi', bie në pranga Astrit Avdylaj 50 vjeç. Personazhi i njohur i botës së krimit, u arrestua në vilën tij në Shijak, informoi sot (29 qershor 2024) policia e shtetit. Në momentin që iu vendosën prangat Astrit Avdylaj, ishte i armatosur me pistolete te mbushur.

Nga pamjet e operacionit te arrestimit duket momentin kur RENEA mësyn vilën e Avdylajt me mure të larta dhe me dyer të mëdha.

Ndaj tij ishte firmosur një urdhërarrest nga GJKKO me kërkesë të SPAK në kuadër të operacionit 'Revanshi' të nisur në maj të këtij viti nën akuzat "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale per te kryer vrasje"", Grup i strukuruar kriminal" dhe "Pjesmarrje në grup të strukturuar."



LEXO EDHE:
Shoqëroi Ervis Martinajn dhe ishte kontakti i fundit para zhdukjes! Prokuroria bën rekurs në Gjykatën e Lartë dënimin me 2 vite e 10 muaj burg të Jeton Lamit

Operacioni i arrestimit tw Avdylajt u krye nwn masa tw larta sigurie.

> *"Operacioni u krye në masa të larta sigurise, bazuar në inteligjencën policore për vendodhjen e një të shumëkërkuari me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Kapet dhe vihet në pranga shtetasi Astrit Avdyli, 50 vjeç, banues në Shijak, i shpallur në kërkim në kuadër të operacionit "Revanshi".*
> *Në momentin e ndërhyrjes së forcave policore, 50 vjeçarit ju gjet një armë zjarri pistoletë me municion luftarak. Në vijim të veprimeve, Specialistët e Sektorit për Hetimin e Grupeve Kriminale në Departamentin e Policisë Krimianale, bënë të mundur ekzekutimin e vendimit të Gjykatës, e cila ka caktuar ndaj këtij shtetasi masën e sigurisë "Arrest në burg". Operacioni "Revanshi" vijon" thuhet në njoftimin e policisë.*

Operacioni Revanshi

Nga zbardhja e komunikimeve në aplikacionin SKY ECC, Avdyli bashkëpunonte dhe thurte plane me grupin e ish-deputetit socialist Arben Noka dhe grupin e Ervis Martinaj për të ekzekutuar Durim Bamin. Ky i fundit është arrestuar në Dubai dhe nuk dihet nëse do të ekstradohet apo jo në Shqipëri.

Arben Ndoka dyshonte se Durim Bami kishte marrë pjesë në vrasjen e vëllait të tij, Aleksandër Ndoka ndërsa Martinaj dyshonte se ai bashkëpunonte me kundërshtarët e tij, Indrit Dokle e Leonard Duka. Për kokën e Durim Bamit në ndihmë të Ervis Martinaj e Arben Ndokës shkoi dhe Emiljano Shullazi dhe Astrit Avdyli të cilët ndodheshin atëkohë në qeli. Sipas dosjes Emiljano Shullazi kontaktoi një nga të besuarit e tij për vrasjen e Bamit si dhe siguronte informacione për lëvizjet e tij dhe ia dërgonte Arben Ndokës.

Megjithatë atentatet ndaj Durim Bamit dështuan. Ky i fundit nga ana tjetër, shfaqet në konflikt të hapur me grupet e Martinajt e Ndokës. Durim Bami bën aleancë me grupet e kundërshtarëve të Martinajt që drejtoheshin nga Leonard Duka dhe Indrit Doklen si dhe tentuan vrasjen e Martinajt, por dështuan derisa mbreti i bixhozit u zhduk pa gjurmë.

Kush e arrestoi

Operacioni u organizua nga Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale në DPPSH me mbështetjen e Forcave Speciale Renea.

Lajmi i fundit

Euro 2024/ Zvicër 2-0 Itali, notat e lojtarëve! Barella dështim, Xhaka lider! Vargas më i miri

29 Qershor, 20:22

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

PERSONAT ME URDHËR-ARRESTE

1. Arben Ndoka – në kërkim
2. Arian Tuku-i arrestuar
3. Ilia Ndoka- i arrestuar
4. Samuel Ndoka- në kërkim
5. Vinçens Tuku- në kërkim
6. Ervis Martinaj- në kërkim i zhdukur prej 2022
7. Jozi Kraja- në kërkim
8. Astrit Avdyli- i arrestuar
9. Aldo Avdyli- në kërkim
10. Miri Bruli- i arrestuar
11. Naim Stafuka-arrestuar
12. Emiljano Shullazi- i arrestuar
13. Blerim Abazi-i arrestuar
14. Elvis Ndreca- arrestuar
15. Oltion Zefi-
16. Edson Jozëik
17. Armando Ndreca- i arrestuar
18. Kasandër Noga- i arrestuar
19. Elson Reçi
20. Besian Xhixha- i arrestuar
21. Enver Diya- arrestuar
22. Robert Laçi- i arrestuar
23. Fatmir Troplini -i shpallur në kërkim
24. Klodian Shahini- i arrestuar
25. Henerigert Mitri- i arrestuar
26. Gjergji Cukali- i arrestuar
27. Kristos Teta
28. Denis Meta- arrestuar
29. Gentian Binjaku
30. Viktor Imeraj- i arrestuar
31. Satilno Basho-në kerkim
32. Marklen Haka- në kërkim
33. Tori Xheçuka- në kërkim
34. Edison Muçeku- në kërkim
35. Albert Zaja- në kërkim
36. Florenc Kelmendi- në kërkim
37. Ardit Gjokrosa- në kërkim
38. Deivis Bajramaj- i arrestuar
39. Adrian Pikli- në kërkim
40. Durim Bami- arrestuar
41. Endrit Dokle- arrestuar
42. Xhelal Rraja-
43. Altin Morina
44. Leonard Duka
45. Erlis Duka-ne kërkim
46. Fatmir Hyseni-në kërkim
47. Altin Gega-në kërkim
48. Drianto Bardhi- i arrestuar
49. Fabio Ballabani- në kërkim
50. Elton Zalla- në kërkim

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:40

Kush është Astrit Avdylaj, kreu i bandës së Shijakut! Nga vrasja në '97 tek droga, e gjithë jeta nëpër burgje

Avdylajt në Shijak u bënë me emër që në vitet 90'. Në 1996-ën është vrarë me armë zjarri Dritan Avdyli, kushëriri i parë i Astrit Avdylit. Ky i fundit, i dënuar më parë për prostitucion në Itali mori hak në 1997 duke vrarë në qendër të Shijakut personin që nxori në pritë Dritanin.

Ai i kishte vendosur një gjobë biznesmenit Tefik Hyka, pronari i fabrikës së tullave në Vlorë. Dritan Avdyli u telefonua nga një bashkëpunëtor shijakas i Tefik Hykës për të shkuar në zonën e “Katër Rrugëve të Shijakut” për të marrë gjobën që kishte vënë, por në momentin që bashkë me shokun arrin në lokal goditet me breshëri plumbash. Hakmarrja nuk u ndal me kaq, pasi vëllai i Astritit, Shkëlqimi vrau në Tiranë, Durim Kusin, i njohur si vrasës me pagesë. Pas Astritit, në role të tjera, janë edhe familjarët Jasmin, Flamur , Altin.

Astrit Avdyli u lirua 3 vite para se të mbaronte dënimin pasi u ekzaminua me “depresion dhe tentativa vetëvrasëse”. i dënuar me 16 vjet burg për vrasje, Avdyli për 10 vjet rresht kërkoi lirim të parakohshëm nga burgu i Shënkollit-dhe në fund e fitoi, pasi siguroi më parë një raport mjekësor që e diagnostikonte atë me “depresion endogjen me tentativa vetëvrasëse”. Ai doli nga burgu më 2 mars 2016. Gjykata e Lartë urdhëroi lirimin e tij me argumentin se “qëndrimi në burg i rrezikonte jetën”. Jo shumë më vonë, Avdyli do të hetohej për trafikun e drogërave të forta. Me origjinë çame, Astriti, në rrethin e zonës, njihet si I ‘Urti”, pasi punët I zgjidhte me bisedime.

Prokuroria e Krimeve të Rënda bëri me qindra orë përgjime dhe ndërroi tre grupe prokurorësh, dhe në 2018 ngriti akuza për 44 persona të akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, korrupsion, ushtrim ndikimi të paligjshëm apo falsifikime masive me pronat. Astrit Avdylaj është liruar nga qelia e paraburgimit dy vite pas arrestimit të bujshëm, në korrik 2021 dhe përfundoi në 'arrest në shtëpi'. Media gjermane "Bild" publikoi biseda të tij dhe me ish-kreun e Bashkisë Durrës, Vangjush Dako ku flitej për sigurimin e votave në zgjedhjet e 2017.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 16:02

U arrestua sot nga RENEA, Report Tv siguron foton e Astrit Avdylajt

Report Tv siguron foton e Astrit Avdylajt, i cilësuar si kreu i bandës së Shijakut, që u arrestua ditën e sotme në kuadër të operacionit 'Revanshi' pasi ishte shpallur në kërkim nga SPAK. 50-vjeçar është një emër i njohur i botës se krimit, ndërsa në momentin që u prangos ishte i armatosur.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 14:55

U arrestua sot nga RENEA, si u lirua nga paraburgimi Astrit Avdylaj dhe gjyqi për 200 kg heroinë në laboratorin e Hasit

Foto: Astrit Avdylaj dhe momenti i arrestimit te tij

Altin Avdyli, i cilësuar si kreu i bandës së Shijakut u arrestua në vitin 2018 si pjesë e dosjes "339", gjatë operacionit "Volvo 4" për laboratorin e kokainës që u gjet ne Has dhe sekuestrimin e 200 kg heroinë, por dosja mbeti pezull për një kohë të gjatë duke çuar në skadimin e afateve të paraburgimit ndërkohë që gjykimi vijonte në gjëndje të lirë. Në shkurt 2020 u bë subjekt i OFL-së duke i kërkuar justifikimin e pasurisë

Në korrik 2021 ai u lirua nga burgu për shkak të tejkalimit të afateve së bashku dhe me Jasin Kala, Fatos Llavdiu.

Gjatë hetimit rezultoi se Astrit Avdyli dhe personat e tjerë merreshin me trafikimin e sasive të madhe të lëndëve narkotike nga Shqipëria në drejtim të Italisë dhe vendeve të tjera Evropiane.

Në tetor 2022 Astrit Avdylaj u mor në pyetje pas raportimeve në media se anëtarë të fisit Avdylaj janë përmendur si kontakti i fundit me të shumëkërkuarin Ervis Martinaj.

Nw prill 2023 Apeli i GJKKO-së prishi dënimin me 12 vite burg për Astrit Avdylin dhe riktheu dosjen për gjykim ne GJKKO.

Ndërkohë më përpara ka qenë i dënuar me 12 vite nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale "Vrasja me paramendim" për një vrasje të ndodhur në vitin 1996 ku u ekzekutua me armë zjarri Dritan Avdyli, kushëriri i parë i Astritit.

Ndërkohë hetimet e SPAK që nisën pas transkriptimeve të bisedave përmes kodeve 'Sky' që këta persona përdornin me njëri-tjetrin zbuluan lidhjet e bandës së Avdylajve në Shijak me atë të Bajrave në Shkodër dhe Ndokajve në Lezhë.

Sot Astrit Advyli, 50 vjeçar u arrestua në kuadër të operacionit Revanshi pasi akuzohet se ka siguruar kushtet për vrasjen e Durim Bamit.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:00

VIDEOLAJM/ Arrestohet Astrit Avdylaj, momenti kur RENEA mësyn vilën me mure të larta në Shijak

Policia e shtetit ka publikuar pamjet e operacionit të arrestimit të tij. Në momentin kur forcat RENEA kanë hyrë në vilën e Avdylajt.

“Arratia nga përballja me drejtësinë po merr përgjigjen e duhur çdo ditë. Përgëzime Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës dhe RENEA për gjetjen dhe ndalimin e një shtetasi të kërkuar nga drejtësia në Shijak. Mbështetja për Policinë e Shtetit dhe rritja e bashkëpunimi me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit po konsolidon revanshin e sundimit të ligjit kundër krimit të organizuar” shkruan ministri i Brendshëm Taulant Balla në një postim në facebook.

Nga pamjet duket që vila është e rrethuar me mure të larta prej betoni.

S.G/Shqiptarja.com

Share

S.G/M.Q./Shqiptarja.com

TAG: astrit avdylaj | sky-spak | revanshi | Durres | shijak

Komento

Komente

Dante: 29/06/2024 20:09

Tani sebashku me torin prej vlore boni ndonje loj tavull e dam sa tju bien dhembet hahhahah

Përgjigju

Geri: 29/06/2024 16:07

I lumte policise se shtetit!

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:

Censi 2023, popullsia u tkurr me 419 mijë në 12 vite, cili është shkaku?

Emigrimi | Lindshmëria | Vdekshmëria

Lajme të tjera

Devijohet lëvizja në disa rrugë të Durrësit gjatë sezonit veror, Bulevardi 'Epidamn' kthehet në pedonale

Aldo Mustafa

28 Qershor, 17:08

Të ardhura nga krimi, sekuestrohen 111 mijë paund në Portin e Durrësit! 47-vjeçari i solli nga Britania e Madhe

28 Qershor, 14:04

Apeli i GJKKO-së rrëzon ankimet e Emiljano Shullazit dhe 11 të tjerëve

28 Qershor, 10:26

Kultivonin kanabis, arrestohen tre vellezër në Durrës! Momenti kur kapen duke prashitur bimët narkotike

28 Qershor, 08:30

Vangjush Dako kërkoi gjykim të shkurtuar, GJKKO vendos më 8 korrik nëse do ta pranojë ose jo

Keti Banushi

27 Qershor, 15:41

Porti i ri në Porto Romano, Rama autorizon Autoritetin Portual të nisë negociatat për marrëveshje konsulence me Royal Haskoning DHV

26 Qershor, 23:13

VIDEO/ Mbetjet shtazore i hidhnin në gropa, nën hetim 4 administratorë subjektesh në Tiranë e Berat! Kontrolle në 18 biznese

26 Qershor, 18:00

Durrës/ Pamje mahnitëse nga hijeshia e flamingove në Rrushkull

26 Qershor, 09:41



Jo më parkime falas në Durrës, Këshilli Bashkiak miraton pagesën me votat e socialistëve (Rrugët + Tarifat)

Aldo Mustafa

25 Qershor, 18:46

Durrës/ Zaptuan me çadra e shezlongë plazhet publike dhe ndërtuan pa leje ‘beach bar’-e, 7 persona në hetim

25 Qershor, 11:26

Durrës, rikthehen në shëtitoren “Taulantia” statujat e 4 ikonave të 'Rock and Roll'

Artur Korriku

24 Qershor, 17:18

Spille, 66 vjeçari humb jetën në det

24 Qershor, 13:18

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje